

# Raporti për Kosovën 2015, 2016...progres apo regres?

Komisioni Evropian në kuadër të strategjisë për zgjerim të Bashkimit Evropian publikon çdo vit raporte vjetore mbi vendet candidate dhe ato potencialisht candidate të Ballkanit që synojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Për këto vende tashmë 10 vjet e më shumë Komisioni Evropian për çdo vit publikon raportet, të cilat pasqyrojnë situatën në përbushjen e kriterëve të Kopenhagës - si kriteret politike, ekonomike dhe standardet evropiane. Vlerat kryesore të BE-së kanë të bëjnë me ekonominë e lirë të tregut, lëvizjen e lirë të njerëzve dhe demokracinë e vendit. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim preken të gjitha sferat e jetës, duke filluar me ato që kryesisht kanë të bëjnë me rregullimin e tregtisë së lirë të mallrave ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Por aspekti kryesor i saj ka të bëjë me rregullimin e sundimit të ligjit, demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe marrëdhëniet rajonale. Se ku qëndron Kosova vit pas viti në raport me përbushjen e kriterëve të Kopenhagës është pyetja kryesore e cila adresohet në të ashtuquajturin "Raporti i progresit".

Raporti i këtij viti nuk mund të quhet "Raport i progresit apo i regresit" pasi që ai paraqet një pasqyrë të saktë mbi realitetin që mbizotëron, mbi punën që është bërë dhe që duhet bërë për t'i përbushur kriteret e cekura. Që nga viti i kaluar Komisioni Evropian ka ndryshuar metodologjinë e raportit. Raporti i sivjetshëm për Kosovën në krahasim me raportin e vitit të kaluar është që tani Komisioni Evropian përdor një gjuhë ndryshe dhe shkallë të tjera të vlerësimit mbi të cilën i adresohet Kosovës dhe se ky raport është më i balancuar sa i përket detyrave dhe arritjeve. Për herë të parë në raport përdoren terme specifike se kujt i adresohen rekomandimet apo edhe kritikën. Më parë qëndrimi ka qenë se Kosova duhet të ketë gjyqësor të pavarur, tani kemi rekomandime që Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial dhe Policia e Kosovës duhet të punojnë për të krijuar një mjedis të pavarur dhe të punojnë në mënyrë të pavarur për sundim të ligjit, po ashtu vendosja e prioritetëve në të cilat duhet t'u kushtohet një vëmendje e veçantë. Raporti pothuajse është përsëritje e raporteve të viteve të kaluara meqë përsëri kërkohet reformimi i Administratës Publike, pavarësia e gjyqësorit, ndalimi i ndikimeve politike në administratë, auditimi i financave të partive politike, zbatim i ligjeve e të ngjashme.

Një mëdyshje hidhet mbi këtë raport se a me të vertetë pasqyron situatën në Kosovë duke marrë parasysh mostrat, të cilat përdoren për të arritur tek një raportim i saktë mbi gjendjen në Kosovë. Duhet konsideruar se ambasadat e vendeve anëtare të BE-së dhe mosritja e përfshirjes së organizat-

ave joqeveritare lokale nuk mund të japin një pasqyrë të drejtë të situatës, sido që të jetë ajo. Edhe pse raporti mbi Kosovën vit pas viti tregon progreset, të cilat bëhen rreth shtetndërtimit, në të cilin përfshihen fillimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, prapë vërehet një stagnim apo regres kur vjen koha që të merren vendimet përfundimtare kundrejt dukurive të lartcekura. Rasti i (mos)ratifikimit të Marrëveshjes së Demarkacionit në mes Kosovës dhe Malit të Zi si kusht për liberalizimin e vizave tregon që nuk ka konsensus shoqëror për marrjen e vendimeve të vështira, që kërkojnë dialog të brendshëm. Ndikimi i ndërkombëtarëve sa vjen e zvogëlohet në raport me vendosjen e presionit të tyre karshi liderëve tanë për të marrë vendime. Është e arsyeshme që të vlerësohet se ka ardhur koha që liderët tanë të fillojnë të jenë të pavarur dhe të jenë bashkëpunues me njëri-tjetrin për marrjen e vendimeve. Edhe pse shoqëria kosovare është shumë e ndarë dhe çështja e ratifikimit të Demarkacionit me Malin e Zi është politizuar tej mase, agjenda evropiane dhe integrimi i Kosovës në BE është agjenda e vetme shtetërore. Kjo agjendë

shtetërore përfshin reforma ekonomike, administrative, për integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike, por zbatimin e saj lë shumë për të dëshiruar. Kjo për shkak të vlerësimit qytetar se Kosova në këtë drejtim është shumë mbraja në krahasim me vendet anëtare, por edhe nga vetë vendet tjera të Ballkanit. Mungesa e zbatimit të reformave dhe ligjeve të aprovuar bënë që Kosova të mos jetë në gjendje të ecë përpara me agjendën e saj evropiane. Kosova duke qenë shtet i ri ka adoptuar në sistemin e saj shumë praktika të mira evropiane, të cilat kanë bërë shumë konfuz qytetarët se ku t'i adresojnë çështjet e tyre për shkak të numrit të "këshillave" dhe "agjencive" të pavarura, që tashmë janë bërë problem meqë ato funksionojnë të fragmentuara dhe nuk ka linja të qarta të llogaridhënies dhe përgjegjësisë.

Por, megjithatë, raporti nuk u adresohet vetëm institucioneve publike, por është gjithëpërfshirës dhe i adresohet të gjithë qytetarëve të Kosovës. Shqetësimet dhe inputet e shoqërisë civile janë marrë parasysh dhe tani rekomandimet janë një mundësi e mirë për t'i shtyrë gjërat përpara, kjo sa i përket konsultimeve publike me shoqërinë civile dhe ndërtimin e transparencës në financimin e shoqërisë civile. Raporti duhet të përvetësohet dhe të shërbejë si pikënisje për fillimin e reformave në shtetin tonë. Këto reforma nuk duhet të bëhen për t'i përbushur detyrimet ndaj Bashkimit Evropian, por për ta përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve tanë.



Blerina Ramaj

Shërbimi i Mbrojtjes së Luftës dhe Luftëmbajtjes së Mbrojtjes së Kosovës është nën kontroll të shtetit dhe të bashkimit të shtetit. Projekti i ri i shtetit për 2017 në bashkëpunim me shtetin e Kosovës është nën kontroll të shtetit dhe të bashkimit të shtetit.

Shërbimi i Mbrojtjes së Luftës dhe Luftëmbajtjes së Mbrojtjes së Kosovës është nën kontroll të shtetit dhe të bashkimit të shtetit. Projekti i ri i shtetit për 2017 në bashkëpunim me shtetin e Kosovës është nën kontroll të shtetit dhe të bashkimit të shtetit.